

**TIPOLOGJIA E BASHKËPUNËTORËVE ZYRTARË (ANËTARËT).
SHERLOKHOLMËSËT SI PROTOTIP DHE SHPREHJE E PASHPIRTËSISË.**

Z. SELAMI ZALLI

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM/ DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TRAJTIMIT
TË KËRKESAVE AIDSSH**

ABSTRAKT

Ky punim ka për qëllim dhe përqendrohet në analizën e strukturave dhe identifikimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit në Shqipëri gjatë periudhës 1945–1991, duke u ndalur në kategoritë dhe llojet e bashkëpunëtorëve të Sigurimit, me theks të veçantë te bashkëpunëtori zyrtar (anëtar) i Organeve të Sigurimit të Shtetit (OSSH).

Në trajtimin e kësaj teme kam zgjedhur të analizoj bashkëpunëtorin zyrtar (OS), duke u ndalur konkretisht në disa prej tyre, ndonëse vetëm për një numër të kufizuar ka qenë e mundur njohja e plotë e dosjeve dhe dokumentacionit përkatës. Ky dokumentacion paraqitet kryesisht në formën e dosjeve të personelit, ku gjenden vërtetime biografike, vlerësime pune, si dhe masa disiplinore, përmes të cilave mund të ndërtohet identiteti i përzgjedhjes dhe pranueshmërisë së tyre, si dhe veprimtaria konkrete e këtyre subjekteve, deri edhe në përfshirje në akte kriminale.

Analiza mbështetet në studimin krahasues të dosjeve model të këtyre bashkëpunëtorëve, në raport me kërkesat ligjore dhe veprimtarinë e tyre konkrete. Vëmendje e veçantë i kushtohet mënyrës së përzgjedhjes, mekanizmave të kontrollit dhe qëndrimit të institucioneve ndaj tyre në rastet e konstatimit të shkeljeve, si dhe mënyrës së pasqyrit të këtyre gjetjeve në dosjet e kuadrit dhe të personelit për secilin individ, si edhe në aktet e hartuara gjatë veprimtarisë së tyre profesionale.

Punimi synon të analizojë konkretisht dosjet e bashkëpunëtorëve zyrtarë të Sigurimit të Shtetit, si Ferat Matochiti, Vilson Pecani, Petrit Hakani, Idriz Seiti, Ilmi Seiti, Hekuran Pobrat, Marko Vodica, Nisti Karenxhiu, Vaskë Koleci, Zoi Themeli, Nevzat Haznedari, Sulejman Abazi, Kopi Nika, Beqir Ndou, Hasan Haxhia, Medi Agolli, Seit Zeqiri dhe Ndreç Gjoka, në rast se këto dosje do të vihen në dispozicion për trajtim shkencor në kuadër të simpoziumit.

Ky punim përbën një kontribut në ndërtimin dhe qartësimin e një panorame më të qartë mbi atë çfarë ishte dhe çfarë përfaqësonte Sigurimi i Shtetit, si dhe mbi logjikën e përzgjedhjes dhe ndërtimit të rrjetit të tij të bashkëpunëtorëve.

Metodologjia e kërkimit bazohet në kërkimin dhe interpretimin e dokumentacionit arkivor në dispozicion, analizën e përmbajtjes së tij, standardet e përdorura, arsyet e gjendjes së konstatuar dhe qëndrimet institucionale ndaj saj.

Fjalë kyçe: *dosje personeli, dosje personale, Sigurimi i Shtetit, oficer i Sigurimit, bashkëpunëtorë, karakteristikë, dekorim, masa disiplinore.*